



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Adresimi i Ministrit të Shëndetësisë Arben Vitia në konferencën e shteme për media

Prishtinë, 13 prill 2020

Të dashur qytetarë,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Mbrëmë u konfirmuan edhe 79 raste të reja me COVID 19 në Republikën e Kosovës. Këto ditë të vështira, përkundër se një pjesë e mirë e rekomandimeve janë respektuar nga shumica e qytetarëve, për shkak të ndryshme duke përfshirë edhe motin e mirë këto ditë, kemi parë se jo sa duhet janë respektuar këto masa dhe rekomandime.

Pas kësaj situate, me rekomandim të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK-së), për shkak të situatës së krijuar tashmë në vend dhe pas shfaqjes së rasteve të fundit me sëmundjen Covid-19, Ministria e Shëndetësisë sot pas diskutimeve të gjata me ministrat e Ekonomisë, Punësimin, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS) znj. Rozeta Hajdari, Ministrin e Punëve të Brendshme (MPB)-së, Xhelal Sveçla dhe Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Emilia Rexhepi dhe grupet teknike nga këto Ministri, në bashkëpunim edhe me kryetarët e komunave përmes Asociacionit të Komunave, mori vendim që përfshin masa të reja për parandalimin dhe luftimin e sëmundjes ngjithëse Covid 19 për ta mbrojtur shëndetin publik.

Qytetarë të nderuar,

Fillimisht ju falënderoj për bashkëpunimin dhe kujdesin e treguar deri më tani. Mirëpo, ky kujdes tash e tutje duhet të jetë shumë më i shtuar për ta mbajtur të sheshtë lakoren e

infektiveve. Nuk mundemi më të tolerojmë gabime dhe lëshime në këtë situatë ku në lojë është shëndeti i qytetarëve tanë dhe jetët tona.

Sot është jetike që këto masa të cilat do të hyjnë në fuqi nga dita e nesërme, në ora 17.00, të zbatohen me përpikëri nga të gjithë ne. Organet përkatëse do të kujdesen që këto masa të zbatohen deri në përpikëri. Mund të duken rigorozë, por përvoja nga shtetet tjera na ka mësuar se nëse tash nuk veprojmë, mund të bëhet vonë dhe pas një kohe përsëri do të detyrohemi t'i marrim këto masa por me kosto shumë më të madhe edhe për jetët e qytetarëve tanë por edhe për shëndetin e ekonomisë.

Megjithatë, nëse të gjithë bashkëpunojmë me njeri-tjetrin, institucionet me qytetaret, mund të sigurojmë që këto masa të mbeten në fuqi për një periudhë sa më të shkurtër që të jete e mundur. Kjo varet jo vetëm prej nesh në Qeveri, por edhe prej të gjithë jush si qytetare. Është natyra e virusit të cilën po përballemi, që edhe një masë shumë e vogël e mosbindjes nga ana e disa qytetarëve, mund të rrezikojë të gjithë ne të tjerët. Sa më shumë që t'i respektojmë këto masa, aq më shpejt do ta mposhtim virusin dhe t'i kthehemi jetës normale.

Sidomos këto dy javët e para do të jene kritike. Këto javët e para do të na testojnë durimin jashtë mase. Presim që numri i rasteve do të rritet dukshëm gjatë këtyre dy javëve, përpara se të fillojë të bjere në mënyrë graduale por të vazhdueshme. Por edhe një herë, gjithçka varet nga bashkëpunimi, disiplina jonë, si dhe nga besimi ynë që me një periudhë të shkurtër të kufizimeve rigorozë, do të arrijmë një kthim sa më shpejt në normalitet.

Më lejoni të lexoj këto masa:

I. Prej datës 15 prill 2020, në orën 17:00, ndalohet qarkullimi i personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në Komuna, përveç rasteve në vijim:

(a) **Për personat fizikë mbi moshën 16 vjeçare** lejohet qarkullimi për furnizim me mallra të domosdoshme (ushqim dhe barna për njerëz dhe kafshë/shpezë dhe produkte higjienike) dhe për të kryer detyrat dhe nevojat financiare (pagesat, punët bankare), **për 1 orë e gjysmë në ditë**, sipas orarit të përcaktuar ditor në bazë të shifrës së parafundit të numrit të tyre personal. Për shtetasit e huaj që nuk posedojnë numrin personal të Republikës së Kosovës, orari i lejuar i daljes përcaktohet bazuar në shifrën e parafundit të numrit të pasaportës.

(b) Gjatë qarkullimit të personave fizikë për furnizim me mallra të domosdoshme, **nuk lejohet shoqërim nga asnjë person tjetër**, përveç në dy raste:

(1) personat me aftësi të kufizuara, të cilët mund të shoqërohen vetëm nga një anëtar tjetër i së njëjtës bashkësi familjare, apo nga një asistent i posaçëm mjekësor dhe

(2) personat nën moshën 16 vjeçare, me kusht që të jenë të shoqëruar nga një anëtar i së njëjtës bashkësisë familjare me të njëjtin shtëpive/banesave.

(c) Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të COVID-19 ndaj personave në moshë **rekomandohen** personat mbi moshën 65 vjeçare që të mos dalin nga shtëpia/banesa përveç në raste urgjente dhe të domosdoshme.

Duhet theksuar se shumica e qytetarëve do të kenë vetëm këtë mundësi të dalin nga shtëpia, një herë në ditë, për 1 orë e gjysmë, për të kryer furnizimin me mallra të domosdoshme, si dhe detyrat dhe nevojat financiare.

Megjithatë, për të ruajtur funksionimin e administratës shtetërore dhe veprimtari esenciale të ekonomisë, jemi pajtuar të bëjmë disa përjashtime.

(d) Me leje të veçantë dhe **vetëm për të kryer nevojat e operatorëve ekonomikë**, mundësohet:

(1) qarkullimi i lirë për operatorët ekonomikë dhe institucionet të parapara në listën e bashkëngjitur si Aneksi I i këtij vendim. Kjo do të bëhet publike dhe do të njoftohen të gjithë ata operatorë ekonomik që ju lejohet një gjë e tillë.

(2) transporti i lirë i mallrave dhe shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit — si proces që përfshin veprimet nga lënda e parë në prodhim, përpunim e shërbim gjer të transporti i produkteve, shpërndarja dhe shitja te konsumatori i fundit — për veprimtaritë e lejuara sipas dhe institucioneve të parapara në listën e bashkëngjitur si Aneksi I në këtë vendim.

(e) Me leje të veçantë të qarkullimit dhe **vetëm për të kryer nevojat e institucioneve**, lejohet qarkullimi i lirë për "stafin esencial" të institucioneve shtetërore.

(f) **Vetëm për të kryer detyrat zyrtare**, lejohet qarkullimi i lirë i institucioneve në listën e bashkëngjitur si Aneksi II i këtij vendimi.

(g) Në raste urgjente të shëndetësisë, lejohet dalja nga shtëpia/banesa për të kërkuar trajtim mjekësor në një institucion shëndetësor.

(h) Lejohet qarkullimi për personat fizikë në raste ku është rreptësishtë i domosdoshëm për t'u kujdesur për një ose më shumë të sëmurë, ose për një ose më shumë persona me aftësi të kufizuara.

(i) Ndalimi i qarkullimit të personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre nuk zbatohet në raste të viktimave të dhunës familjare. Viktimave të dhunës familjare u lejohet të dalin nga shtëpive/banesave të tyre për të kërkuar strehim në një lokacion alternativ.

(j) Ndalohet rreptësishtë dalja nga shtëpitë/banesat për çfarëdo arsye tjetër përveç për arsyet e lartcekura, duke përfshirë takime shoqërore, vizita familjare, etj.

II. Për Komunitat që janë në karantinë apo që do të vendosen në të ardhmen bazuar në rekomandimet e IKSHP-së, do të ndalohet hyrje-dalja nga Komunitat përveç në këto raste:

(a) Me leje të veçantë dhe **vetëm për të kryer transportin e mallrave dhe shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit** — si proces që përfshin veprimet nga lënda e parë në prodhim, përpunim e shërbim gjer te transporti i produkteve, shpërndarja dhe shitja te konsumatori i fundit — për veprimtaritë e lejuara sipas dhe institucioneve të parapara në listën e bashkëngjitur si Aneksi I në këtë vendim. Përveç për kryerjen e transportit të mallrave dhe shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit, hyrje-dalja nga Komuna e nuk u lejohet operatorëve ekonomikë, as punëtorëve të tyre.

(b) Me leje të veçantë dhe **vetëm për të kryer nevojat e institucioneve shtetërore**, për "stafin esencial" të këtyre institucioneve.

III. Gjatë qarkullimit të lejueshëm sipas përjashtimeve të parashikuara me pikat I dhe II më lart, personat fizikë obligohen:

(a) të mbajnë të mbuluara gojën dhe hundën, përmes maskës, shallit, apo ndonjë mbulese tjetër;

(b) në çdo kohë, të ruajnë distancë prej dy metrash nga persona të tjerë.

IV. Prej datës 14 prill, ndalohet qarkullimi i automjeteve në Komuna përveçse ne disa raste te rralla:

(d) Me leje të veçantë dhe **vetëm për të kryer nevojat e operatorëve ekonomik**, mundësohet:

(1) qarkullimi i automjeteve për operatorët ekonomik dhe institucionet të parapara në listën e bashkëngjitur si Aneksi I i këtij vendim.

(2) transporti i lirë i mallrave dhe shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit — si proces që përfshin veprimet nga lënda e parë në prodhim, përpunim e shërbim gjer te transporti i produkteve, shpërndarja dhe shitja te konsumatori i fundit — për veprimtaritë e lejuara sipas dhe institucioneve të parapara në listën e bashkëngjitur si Aneksi I në këtë vendim.

(a) Me leje të veçantë të qarkullimit dhe **vetëm për të kryer nevojat e institucioneve shtetërore**, lejohet qarkullimi i lirë i automjeteve për stafin esencial.

(b) Lejohet qarkullimi i automjeteve vetëm për të kryer nevojat e institucioneve, të parapara në listën e bashkëngjitur si Aneks këtij vendimi.

(c) Lejohet qarkullimi i automjeteve për personat me aftësi të kufizuara.

(d) Në raste urgjente të shëndetësisë, lejohet lëvizja me automjet për të kërkuar trajtim mjekësor në një institucion shëndetësor.

(e) **Përveç në raste emergjente dhe për personat me aftësi të kufizuara nuk lejohet më shumë se një (1) pasagjer në automjet.**

(f) Ndalohet rreptësishtë dalja nga shtëpia/banesa për çfarëdo arsyeje tjetër përveç për arsyet e lartcekura.

Mosrespektimi i masave të përcaktuara në këtë vendim konsiderohet, sipas ligjit, si kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë prej 1,000 Euro deri në 2.000 Euro gjobë për personat fizikë dhe prej 3,000 Euro deri në 8.000 Euro për personat juridikë, ndërsa personi përgjegjës i personit juridik dënohet prej 500 Euro gjobë deri me 1,500 Euro.

Masat vlejnjë deri më **4 maj 2020**.

Këto masa nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë do të rishqyrtohet në konsultim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, ekspertët dhe ministritë e tjera të linjës, për të vlerësuar efikasitetin dhe domosdoshmërinë e masave të përcaktuara, si dhe për të vendosur për vazhdimin ose jo të masave përkatëse.

Ne do të ri-analizojmë situatën epidemiologjike çdo ditë dhe në lidhje me secilën pikë dhe, pas konsultave paraprake, mund të ndryshojë, plotësojë apo shfuqizojë masat e përcaktuara.

Të dashur qytetarë,

Apeloj tek të gjithë ju që të tregohemi bashkëpunues dhe vigjilent në zbatimin e këtyre masave ngaqë çdo pakujdesi, sado e vogël, ka çmim të lartë në humbjen e jetëve.

Vetëm nga zbatimi i këtyre masave varet kohëzgjatja e tyre. Sa më bashkëpunues e të bashkuar jemi në këtë situatë, aq më shpejt do të fillojmë edhe me heqjen graduale të këtyre masave. Prandaj ju lutem që të keni kujdes për shëndetin tuaj, ju lutem që të keni kujdes për shëndetin e familjarëve tuaj dhe shëndetin publik të qytetarëve.

Bashkë do t'ia dalim!

Ministrja Rozata Hajdari kërkoi mirëkuptim nga qytetarët dhe subjektet biznesore për këto vendime, sikurse edhe **Ministrja Emilia Rexhepi** e cila tha se këto vendime kanë për qëllim të mbrojnë shëndetin e të gjithëve!

Ministri Xhelal Sfeçla tha se do të bashkëpunohet me të gjitha inspektoratet për zbatimin e vendimeve që këto ditë të vështira të kalohen sa më lehtë nga të gjithë.

Profesori Naser Ramadani tha se këto vendime do të ndikojnë dukshëm dhe do të kenë impakt të drejtpërdrejt në ruajtjen e shëndetit të popullatës së Kosovës.

ENG

Dear citizens,

Distinguished media representatives,

Last night, 79 new cases of COVID 19 were confirmed in the Republic of Kosovo. These difficult days, despite the fact that a good part of the recommendations have been respected by most citizens, for various reasons, including the good weather these days, we have seen that these measures and recommendations have not been respected enough.

Following this situation, on the recommendation of the National Institute of Public Health in Kosovo (NIPHK), due to the situation already created in the country and after the recent cases of Covid-19 disease, the Ministry of Health today after long discussions with the Ministers of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments (MEPTINIS) Mrs. Rozeta Hajdari, the Minister of Internal Affairs (MIA), Xhelal Sveçla and the Minister of Local Government Administration (MLGA), Emilia Rexhepi and technical groups from these Ministries, in cooperation with the mayors through the Municipal Association, took a decision that includes new measures to prevent and combat the contagious disease Covid 19 to protect public health.

Dear citizens,

First of all, thank you for your cooperation and care shown so far. However, this care from now on should be much more added to keep the infection curve flat. We can no longer tolerate mistakes and omissions in this situation where the health of our citizens and our lives is at stake.

Today, it is vital that these measures, which will take effect from the next day, at 17.00, be strictly enforced by all of us. Relevant bodies will ensure that these measures are strictly enforced. They may seem rigorous, but experience from other countries has taught us that if we do not act now, it may be too late and after a while we will again be forced to take these measures, but at a much higher cost to the lives of our citizens. but also for the health of the economy.

However, if we all cooperate with each other, the institutions with the citizens, we can ensure that these measures remain in force for as short a period as possible. This depends not only on us in the Government, but also on all of you as citizens. It is the nature of the virus that we are facing, that even a very small amount of disobedience by some citizens can endanger all of us others. The more we respect these measures, the sooner we will defeat the virus and return to normal life.

Especially these first two weeks will be critical. These first few weeks will test our patience. We expect that the number of cases will increase significantly during these two weeks, before it

starts to fall gradually but steadily. But once again, it all depends on cooperation, our discipline, as well as on our belief that with a short period of strict restrictions, we will achieve a return to normal life as soon as possible.

Allow me read the e following measures:

I. From the date April 15, 2020, at 17:00, is allowed the free movement of natural persons outside their houses / Apartments in the municipality, except in the following cases:

(a) **For natural persons over the age of 16**, the free movement is allowed for the supply of necessary goods (food and medicine for people and animals / poultry and hygienic products) and to perform financial duties and needs (payments, banking), for 1.5 hour during a day, according to the daily set schedule based on the penultimate digit of their personal ID number. For foreign nationals who do not possess the personal number of the Republic of Kosovo, the allowed departure time is determined based on the penultimate digit of the passport number.

(b) During the circulation of natural persons for the supply of necessary goods, **it is not allowed to be accompanied by any other person**, except in two cases.:

(1) **persons with disabilities**, who may be accompanied only by another member of the same family community, or by a special medical assistant and

(2) **persons under the age of 16**, only if they are accompanied by a member of the same family community with the same houses / apartment.

(c) Due to the high risk of COVID-19 for the elderly, persons over the age of 65 are **recommended** not to leave their house / apartment except in urgent and necessary cases.

It should be noted that most citizens will only have this opportunity to leave the house, once a day, for 1 hour and a half, to carry out the supply of necessary goods, as well as financial tasks and needs.

However, to maintain the functioning of the state administration and activities essential to the economy, we have agreed to make some exceptions.

(d) With special permission and **only to carry out the needs of economic operators**, is enabled as following:

(1) free movement for economic operators and institutions foreseen in the list attached as Annex I of this decision. This will be made public and all those economic operators that are allowed to do so will be notified.

(2) free transport of goods and services to ensure the functioning of the supply chain - as a process that includes actions from raw material to production, processing and service to the

transport of products, distribution and sale to the end consumer - for activities allowed according to the institutions provided in the list attached as Annex I to this decision.

(e) With special free movement permits and **only to meet the needs of institutions**, free circulation is allowed for the "essential staff" of state institutions.

(f) **Only to perform official duties**, the free movement of institutions is allowed in the list attached as Annex II of this decision.

(g) In health emergencies, exit allowed out of the house / apartment to seek medical treatment in a health institution.

(h) Traffic is allowed for natural persons in cases where it is strictly necessary to care for one or more patients, or for one or more persons with disabilities.

(i) Prohibition of movement of natural persons outside their houses / apartments does not apply in cases of domestic violence victims. Victims of domestic violence are allowed to leave their homes / apartments to seek refuge in an alternative location.

(j) It is strictly forbidden to leave houses / apartments for any reason other than for the above reasons, including social gatherings, family visits, etc.

II. For Municipalities that are in quarantine or that will be placed in the future based on the recommendations of the NIPH, entry and exit from the Municipalities will be prohibited except for the following cases:

(a) With special permission and **only to carry out the transport of goods and services to ensure the operation of the supply chain** - as a process that includes actions from raw material in production, processing and service to the transport of products, distribution and selling to the last consumer - for activities permitted under the institutions provided in the list attached as Annex I to this decision. In addition to transporting goods and services to ensure the operation of the supply chain, entry and exit from the Municipality is not allowed to economic operators or their workers.

(b) With special permission and only to meet the needs of state institutions, for the "essential staff" of these institutions.

III. During the permission of free movement, according to the exceptions provided for in points I and II above, natural persons are obliged

(a) keep your mouth and nose covered, through a mask, scarf, or other cover;

(b) at all times, maintain a distance of two meters from other persons.

IV. From April 14, the circulation of vehicles in the Municipality is prohibited, except in some rare cases:

- (c) With special permission and **only to meet the needs of economic operators**, it is possible:
- (1) vehicle traffic for economic operators and institutions foreseen in the list attached as Annex I of this decision.
 - (2) free transport of goods and services to ensure the functioning of the supply chain - as a process involving raw material production, processing and service operations until the transport of products, distribution and sale to the final consumer - for activities permitted under and the institutions provided for in the list attached as Annex I to this decision.
- (a) With the special permission of the traffic and **only to carry out the needs of the state institutions**, the free circulation of vehicles for the essential staff is allowed.
- (b) Vehicle traffic is allowed only to meet the needs of the institutions, provided in the list attached as Annex to this decision.
- (c) Vehicle traffic is allowed for people with disabilities.
- (d) In urgent health cases, driving is permitted to seek medical treatment in a health institution.
- (e) **Except in emergencies and persons with disabilities, no more than one (1) passenger in the vehicle is permitted.**
- (f) It is strictly forbidden to leave the house / apartment for any reason other than the above mentioned reasons.

Non-compliance with the measures set out in this decision is considered, according to the law, as an administrative offense and is punishable by a fine of 1,000 Euro to 2,000 Euros fine for natural persons and from 3,000 Euros to 8,000 Euros for legal entities, while the responsible person of the legal entity is punished. from 500 Euros fine up to 1,500 Euros.

This Decision shall enter into force upon signature and it is valid until May 4 2020.

This the e following measures by the Ministry of Health will be reconsidered in consultation with the National Institute of Public Health, experts and other line ministries, to assess the effectiveness and necessity of the measures set, as well as to decide whether or not to continue the measures.

We will re-analyze the epidemiological situation every day and in relation to each point and, after prior consultation, may change, supplement or repeal the prescribed measures.

Dear citizens,

I urge all of you to be cooperative and vigilant in enforcing these measures, because any negligence, no matter how small, has a high price to pay in losing lives.

Only with the implementation of these measures does their duration depend. The more cooperative and united we are in this situation, the sooner we will start with the gradual removal of these measures. Therefore, please take care of your health, please take care of the health of your family members and the public health of the citizens.

Together we will succeed!

Minister Rozata Hajdari asked for understanding from the citizens and business entities for these decisions, as well as Minister Emilia Rexhepi who said that these decisions are intended to protect everyone's health!

Minister Xhelal Sfeçla said that he will cooperate with all inspectorates for the implementation of decisions so that these difficult days are passed as easily as possible by all.

Professor Naser Ramadani said that these decisions will have a significant impact and will have a direct impact on maintaining the health of the population of Kosovo.

Me respekt,

Divizioni i Komunikimit me Publikun-MSh

038 200 24 131

www.msh.rks-gov.net